

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Vahid Halili dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarve E. K dhe A.M, si dhe ndaj të miturës F. C, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 179 par.1 nën par.1.4 dhe 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, av.A. K dhe av.Xh. M, si dhe ankesës së mbrojtësit të të miturës, av.Rr.G, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, P.nr.13/2015, të dt.11.09.2015, në seancën jo publike të kolegjit, të mbajtur në kuptim të nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, me dt.02.03.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e pjesërishtëm të ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve E.K dhe A.M, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, P.nr.13/2015, i dt.11.09.2015, vetëm sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që Gjykata e Apelit, për veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 179 par.1 nën par.1.4 dhe 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK, më hollësisht të përshkruar në dispozitiv të aktgjyqimit, në bazë të nenit 45 të KPRK, të akuzuarin E. K, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 25(njëzetepesë)vite, të akuzuarin A.M, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 22(njëzetedy)vite, në të cilat dënime iu llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.17.10.2014, e këndej.

II.REFUZOHET e pabazuara ankesa e mbrojtësit të të miturës F.C.

III.Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa prekur.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, P.nr.13/2015, të dt.11.09.2015, të akuzuarit E.K dhe A.M, si dhe e mitura F.C, janë shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 179 par.1 nën par.1.4 dhe 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK, dhe për këtë vepër penale i akuzuari E.K, është gjykuar me dënim me burgim të përjetshëm, i akuzuari A.M, me dënim me burgim të përjetshëm dhe e mitura F.C, me dënim me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 9(nëntë)vite e 10(dhjetë)muaj.

Të akuzuarve koha e kaluar në paraburgim nga dt.17.10.2014, i është llogaritur në dënimin me burgim, ndërsa të miturës F.C, koha e kaluar në paraburgim nga dt.18.10.2014, i është llogaritur dënimi me burgim.

Nga i akuzuari E.K, është konfiskuar vetura e markës "Golf 2", me regjistrim ..., si dhe telefoni HTC, me kartelë të "Ipkos", nga e mitura F.C.

Janë detyruar atë akuzuarit secili veç e veç, që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sado të jenë sipas regjistrimit të shpenzimeve dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç, nga 100Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa për të miturën është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bijën në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari M.A, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit E.K, av.A. K, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim apo aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av.Xh M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet ose aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në kuptim të pretendimeve ankimore.

-Mbrojtësi i të miturës F.C, av.Rr.Gi, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të miturës ti shqiptohet një dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.87/2016, të dt.23.02.2016, ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe të miturës të refuzohen si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata në kuptim të nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit në të cilën ishin prezent Prokurori i Apelit, Xhevdet Bislimi, përfaqësuesi ligjor i të miturës H.C, të akuzuarit E.K dhe A.M, e mitura F.C, mbrojtësit e të akuzuarit E.K, av.A. K dhe av.R K, mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av.Xh.M, dhe mbrojtësi i të miturës F. C, av.Rr. G, ndërsa në seancë nuk prezantoi mbrojtësi i viktimave B. D, i autorizuar i të dëmtuarit av.M D, të cilët janë njoftuar me rregull për seancën e kolegjit, prandaj gjykata nuk pati pengesa ligjore që të mbajë seancën e kolegjit.

Mbrojtësit e të akuzuarve dhe të miturës sqaruan pretendimet ankimore.

Prokurori deklaroi se mbetet pranë propozimit me shkrim.

Mbrojtësit e të akuzuarve dhe të miturës, deklaruan se mbeten pranë propozimeve si në ankesa.

Të akuzuarin dhe e mitura, u deklaruan se përkrahin fjalët e mbrojtësve të tyre.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe të miturës dhe gjeti se:

Ankesa e mbrojtësve të akuzuarve E.K dhe A.M, janë pjesërisht të bazuara, ndërsa ankesa e mbrojtësit të miturës F.C, është e pabazuar.

Pretendimet për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.K, av.A K, pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë kundërthënës në brendinë e tij, ose me arsyet e aktgjykimit, në arsyetim nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare ose janë plotësisht të pa qarta dhe kundërthënëse në masë të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetim të aktgjykimit dhe përmbajtjes së shkresave.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av.Xh.M, pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të KPPK, të parapara në nenin 384 par.1 nën par.1.8 dhe par.2 nën par.2.1 lidhur me nenin 123 par.5, 131 par.4, 132 par.6, dhe 361 par.1 dhe 2 të KPPK.

Aktgjykimi i ankimuar është përshkrim i plotë i procesverbalit nga shqyrtimi gjyqësor. Aktgjykimi është tërësisht i qorientuar pa ndërlidhje logjike dhe pa analizë provash, pa përfundime të qarta për shkak të cilave të meta është i pa kuptueshëm dhe i pa qartë. Dispozitivi përmban kundërthënie brenda për brenda në veçanti kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit, sa i përket përshkrimeve të veprimeve në dispozitiv dhe atyre në arsyetim.

Aktgjykimi bazohet në prova të pa ekzaminuara në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata nuk ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe në ndërlidhje me provat tjera. Me këtë gjendje rezulton përfundimi i gabuar nga gjykata e shkallës së parë. Duke analizuar dispozitivin e këtij aktgjykimi rezulton se i akuzuari në bashkëveprim me të akuzuarin E.K dhe të miturën F.C "... me dashje që ta privojnë nga jeta të ndjerin M. A, për motiv të përfitimit të dobisë pasurore", "...dhe bëjnë planin që t'ia marrin paratë dhe ta privojnë nga jeta, ashtu që i ndajnë rolet dhe punën e tyre në mënyrë dinake etj."

Sipas këtij përshkrimi rrjedh dhe këtë veprim e kanë ndërmarrë dy të akuzuarit dhe e mitura sipas tekstit në dispozitiv ia lidhin duart me maic dhe tojë duke mos u saktësuar se kush janë ata që ia lidhin duart, por gjykata nënkupton për të akuzuarit dhe të miturën. Kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit është në kundërshtim me testin e akuzës, të precizuar në fjalën përfundimtare që ka bërë prokurori si në faqen 11 dhe 17, të theksuar në arsyetim në fillim të pasusit të dytë.

Precizimi është si vijon, "ja heqin rrypin e pantallonave duhet të shtohet "i akuzuari A.M dhe E.K, pasi ia lidhin duart me tojat e të mbathura-këpucëve të tij dhe me maic...", kështoj gjykata ka tejkuluar akuzën dhe kjo e bënë aktgjykimin të pa qëndrueshëm dhe të kundërligjshëm ngase shifet qartë se dispozitivi është në kundërshtim me akuzën.

Duke iu referuar arsytimit të aktgjykimit faqe 20, pasuri i fundit rezulton se gjendja faktike si në dispozitivi, gjykata mbështet në deklaratën e të miturës F, të dhënë në procedurë paraprake, në polici, sipas të cilës deklaratë gjykata konkludon se ajo ishte e qartë dhe precize, ka përshkruar ngjarjen si ka ndodhë dhe se në atë kohë ka pasur kujtesën e freskët dhe ngjarjen e freskët.

Mbështetja e aktgjykimit në këtë deklaratë është në kundërshtim me nenin 261 lidhur me nenin 73, 223 par.5, 131 par.4 dhe 132 par.6 të KPPK. Kjo mbasi mbrojtjes dhe të akuzuarve nuk i është dhënë mundësi të përballjes me deklarata e të miturës, në asnjë fazë të procedurës penale, pra, kjo nuk është bërë as në shqyrtimin gjyqësor në ballafaqim apo në mënyrë tjetër.

Pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë pretendime të pabazuara.

Sipas gjetjes së kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar, nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si pa të drejtë pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve.

Aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në pajtim me nenin 370 par.4,6,7 dhe 8 të KPPK.

Në dispozitiv të aktgjykimit janë përfshirë të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 365 par.1 nën par.1 .1 të KPPK, kështu që gjykata e shkallës së parë, ka shënuar veprën penale për të cilën i ka shpallur fajtor të akuzuarit dhe të miturën, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat është bërë zbatimi i dispozitës së nenit 179 par.1 nën par.1.4 dhe 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit, për të cilat në mënyrë më detale kjo gjykatë do të jap gjetjet e saj te gjendja faktike.

Gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se faktet i ka vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, e që janë nga dëgjimi i dëshmitarëve, prova tjera materiale, dëgjimi i të akuzuarve, të cilat do ti numërojnë një nga një te gjendja faktike, duke dhënë arsye pse konsideron se faktet janë vërtetuar.

Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të veçantë ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarve dhe mos miratimin e mbrojtjes së tyre. Gjykata ka dhënë arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarve E.K, A.M dhe të miturës F.C, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të nenit 179 par.1 nën par.1.4 dhe 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK, ndaj të akuzuarve dhe të miturës dhe veprës së tyre.

Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye për rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

Nga arsyet që u dhanë më lartë, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve E.K dhe A.M, se dispozitivi i aktgjykimit është i partë dhe i pa kuptueshëm dhe se ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit.

Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me arsyetimin e aktgjykimit që ka dhënë gjykata e shkallës së parë. Arsyet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit nuk

janë në kundërthënie me përmbajtjen e shkresave të lëndës apo procesverbaleve si pa të drejtë pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve.

Gjykata e shkallës së parë, ka analizuar çdo provë veç e veç, e pastaj të gjitha së bashku duke dhënë konkludimin apo gjetjet e saj, të cilat konkludime janë të qarta e të cilat konkludime i aprovon edhe kjo gjykatë.

Janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit A.M, se aktgjykimi bazohet në prova të pa ekzaminuara në shqyrtim gjyqësor.

Aktgjykimi i ankimuar bazohet në prova të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A.M, se gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar ka tejkualuar akuzën, sepse gjykata e shkallës së parë, dispozitivin e aktgjykimin të ankimuar e ka hartuar sipas provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, me asnjë fjalë të vetme nuk është tejkualuar akuza, prandaj edhe nuk qëndron pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë ka tejkualuar aktakuzën.

Aktgjykimi bazohet në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor kështu siç është paraparë në nenin 261 të KPK-së. Të akuzuarit dhe e mitura në këtë çështje penale kanë dhënë deklarata disa herë, kështu që aktgjykimi bazohet në deklaratat e të akuzuarve që i kanë dhënë në prezencën e mbrojtësit, dhe në deklarata të cilat janë prova të pranueshme kështu që të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre iu është dhënë mundësia që të përballen me deklaratat e njëri-tjetrit, prandaj edhe aktgjykimi bazohet në prova të pranueshme.

Nga arsyet që u dhanë më lartë, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve se aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Pretendimet për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.K, pretendon se me miratimin e aktgjykimin lëndor gjykata ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, gabimisht ka vërtetuar faktet më të rëndësishme, përkatësisht faktet relevante gjatë miratimit të këtij aktgjykimi. Gjykata e shkallës së parë nuk ka qenë kompetente për gjykimin e kësaj çështje, sepse nuk ka pasur kompetencë territoriale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, pretendon se aktgjykimi mbështetet në gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar. Në bazë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor rezulton se marrëveshja për privimin nga jeta e të ndjerit është zhvilluar në mes të akuzuarit E, dhe të dashurës së tij-të miturës F.C, kjo vërtetohet nga pohimet e të akuzuarit A, dhe pranimin të këtij fakti nga i akuzuari E. Këtë fakt e pohon edhe e mitura, por meqenëse ajo ka dhënë deklaratë vetëm në procedurë paraprake në kundërshtim me nenin 261 të KPK-së, deklarata e tillë nuk mund të shërbejë si bazë e aktgjykimin dhe mbi te nuk mund të shpallet fajtor bashkë kryesi. Sido që të jetë rrjedha e ngjarjes në mënyrë indirekte vërtetohet se i akuzuari E, dhe e mitura kishin planifikuar veprimet e përshkruara në dispozitiv të aktakuzës, pasi F, po zbavitej edhe me të ndjerin. Këtë fakt e konfirmojnë dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor si janë M.A, N.A., E.S, e T.K. Në bazë të këtyre fakteve nuk mund të konfirmohet

qëndrimi i gjykatës si i drejtë dhe i ligjshëm kur pa prova konkrete e shpall fajtor të akuzuarin A.M, por motivet e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.4 e 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ky vlerësim i gabuar i gjykatës së shkallës së parë mohohet edhe nga mendimi i ekspertit mjekoligjor për rrethanat dhe arsyet ankimore të saktësuara të shkelja e ligjit penal.

Pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve se në aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar jo e plotë, ajo që është vërtetuar është e gabuar janë pretendime të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar të gjitha provat e propozuara, duke dëgjuar dëshmitarët: M.A, E.G, N. A, E.S, T. K, S.E dhe B.E, duke dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor ekspertin mjekoligjor Dr. N.U duke lexuar raportet e hyrje daljeve të telefonave të tyre dhe IMEI-et të tyre, kalimet kufitare me bashkudhëtarë nga shtatori dhe në tetor të vitit 2014, kërkesën lidhur me asistencën ndërkombëtare në rrjetin social Facebook-ut, raportin e telefonisë mobile të "Ipkos" lidhur me hyrje-daljet e telefonave, këmbimin e mesazheve midis të miturës F.C dhe dëshmitarit T. K, raportin e njësisë së hetimeve nga policët hetues, raportit të telefonisë mobilite "Ipkos" lidhur me hyrje-daljet, raporti i thirrjeve telefonike midis të ndjerit M, dhe të miturës, raporti i ekzaminimit të veturës i dt. 05.11.2014, raporti i autopsisë i punuar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. N.U i dt. 18.10.2014 lidhur me shkakun e vdekjes së tani të ndjerit M.A, anketa sociale për të miturën me numër 4989/AS-683/2014 e dt. 31.10.2014, vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve të dt. 17.10.2014, lista e dëshmimeve e dt. 17.10.2014, raporti plotësues i teknikës kriminalistike i dt. 17.10.2014 lista e dëshmimeve e dt. 18.10.2014, shikimi i foto dokumentacionit të vendit të ngjarjes si dhe duke dëgjuar të akuzuarit, pas vlerësimit të këtyre provave të administruara ka vërtetuar gjendjen faktike se:

Të akuzuarit E.K dhe A.M dhe e mitura F.C më dt. 12.10.2014, rreth orës 20,30 min. e mitura F.C pas një marrëveshje paraprake me të akuzuarin E.K dhe A.M, në bashkëkryerje me dashje që ta privojë nga jeta tani të ndjerin M.A, me motiv të përfitimt të dobisë pasurore, u takuan në kafiterinë "..." në Obiliq, gjatë darkimit e mitura F.C, u thotë të akuzuarve E.K dhe A.M, se e ka lënë të takohet me një person të rrethi ..., e bëjnë planin për t'ia marrë paratë e ta privojnë nga jeta, ashtu që i ndajnë rolet dhe punët, e në mënyrë dinake, kur e mitura F, takohet te rrethi me tani të ndjerin M, vjen i akuzuari E, me veturën e tij "Golf 2", duke iu sjellë si taksist i rrejshëm "në të zezë", dhe kur arrin te rrethi ..., e mitura F, i preferon tani të ndjerit M, që të hipin në taxi, gjoja për të shëtitur në ..., ashtu që i akuzuari E.K vazhdon me veturë deri te rruga për në fshatin ... ku i akuzuari A.M, ia qet dorën për të hipur në veturë, i njëjti hip në veturë, me qëllim që tani i ndjeri M, të mendoj se është taxi, kështu i akuzuari E.K, vazhdon rrugën për në fshatin .... kthehen përsëri në ..., dhe kur arrin te minimarketi "....", tani i ndjeri M, në gjuhën angleze iu thotë "ndalojeni veturën se nuk më pëlqen kjo vozitje dhe sa të holla u kom borxh" dhe del nga vetura, për një moment nga vetura dalin e mitura F.C dhe të akuzuarit E.K e A.M, i akuzuari E, nxjerr letërnjoftimin dhe i prezantohet si polic tani të ndjerit M, me dhunë të ndjerin M, e fusin në veturë në ulësen e mbrapme, ku ulet edhe i akuzuari E, i njëjti i thotë të akuzuarit A, "hip grahi veturës", kurse në ulësen e përparme ulet e mitura F.C, vazhdojnë rrugën dhe shkojnë në fshatin ..., mbushin veturën me derivate, kthehen përsëri në .... dhe vazhdojnë rrugën në drejtim të fshatit ....., nëpër fshatin ... dhe vazhdojnë në drejtim të një mali në fshatin ..., të ....., vazhdojnë me veturë, derisa vetura nuk ka mundur të shkoj për shkak të rrugëve të ngushta, e ndalojnë veturën dhe vazhdojnë të ecin në këmbë malit derisa arrijnë në vendin e quajtur "...", afër një pusi (bunari), me të arritur e mitura F, iu drejtohet të akuzuarve me fjalët "se këtë duhet me e mbyl se ky pare nuk jep, veç ikë", më pas tani të ndjerit M, ia lidhin duart me maicë dhe tojë, pasi ia lidhin duart me tojat e

këpucëve të tij dhe me maic, i akuzuari E.K dhe A.M, ia hjekin rripin e pantallonave dhe që të dy ia ngjisin rripin në qafë i akuzuari E.K dhe A.M, ia qesin këmbët te qafa, ia shtrëngojnë rripin për ta privuar nga jeta, por kur vërejnë se tani i ndjeri M, ende është gjallë atëherë i kapin gurët dhe e godasin me gur prapa kokës dhe në pjesë tjera të kokës derisa bindën se e kanë privuar nga jeta, e për shkak të gjakderdhjeve trunore nën dhe mbi cipa trunore, M vdes, më pas ia zdeshin rrobat dhe i gjuajnë në bunar, e bunarin e mbyllin me kapak, ia marrin çantën me 200Euro dhe disa dinar, rrobat dhe një telefon, paratë i ndajnë në mes veti dhe largohen nga vendi i ngjarjes. Pas disa ditësh i akuzuari E.K dhe i akuzuari A.M, kthehen në vendin e ngjarjes, e nxjerrin të ndjerin nga bunari dhe e varrosin disa metra afër bunarit, duke e mbuluar me dhe, gur dhe me disa drunj.

Këtë gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, e aprovon edhe kjo gjykatë, si gjendje faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Nga deklaratat e dëshmitarëve M.A, E.G., N.A dhe T.K, vërtetohet fakti se tani i ndjeri M, nuk kishte konflikt me asnjë person. Ishte trajnues për kompjuter në kompaninë ... në ...dhe në .... Kohë pas kohe ishte në ....., për ti trajnuar personat në .... Kishte krijuar lidhje dashurie me F.C, nga Obiliqi. I ndjeri M, ditën kritike me dt.12.10.2014, kishte me u takuar me të miturën F.C, te “.....”.

I ndjeri M. A, kishte lidhje dashurie me të miturën F.C, dhe planifikonte të martohej me të miturën F.C, për këtë arsye kishte porositur babain e tij M.A, që t’ia siguroj restorantin e caktuar në .....

Për të vërtetuar konstatimin e kësaj gjykate se gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe me prova të pranueshme japim disa prej provave kryesore në këtë çështje penale.

I akuzuari E.K, në polici me dt.18.10.2014, në prezencën e mbrojtësit të tij, av.V.Rr, që është provë e pranueshme (sipas nenit 123 par.5 të KPPK), ka theksuar: me dt.12.10.2014, rreth orës 19:45minuta, së bashku me A.M, jemi takuar me F.C, në ... afër shtëpisë së saj dhe prej këtu kemi shkuar në kafiterinë “...”, e cila gjendet te .... Aty kemi pirë kafe dhe kemi shkuar te ... e kemi takuar personin i cili tani është viktimë, e të cilit nuk ia di emrin. Kur kemi dalë nga kafi teria A, ka dalë nga vetura, me këtë person jemi takuar te ..., rreth orës 20:00, unë dhe F, kurse A, na ka pritë te rruga që shkon për në ..., afër ambulancës. Unë kam dalë mbrapa në veturë, së bashku me tani viktimën, kurse A, ka vozitur kerrin dhe përpara ulur ka qenë F. Prej këtu kemi shkuar në .... dhe jemi kthyer te pompa e derivateve “...”, ku i kemi qitur derivate kerrit dhe jemi kthyer rrugës për në .... Mandej kemi vazhduar përmes ..., në vendin e quajtur “...”, dhe aty kemi lënë kerrin dhe kemi vazhduar në drejtim të vendit “...”. Këtu kemi ndejtur disa minuta duke biseduar me F, A, dhe personin që ishte me ne. Gjatë bisedës unë nuk e kam kuptuar se çka ka thënë personi (viktima) sepse ai fliste në gjuhën angleze, kurse përkthimin e bisedës e bënte F. Këtu kemi biseduar, kemi qëndruar rreth 15 minuta. Pas kësaj ka filluar konflikti në mes personit (viktimës)dhe F, unë nuk e kuptoja se çka po thonin, por e vërejtja reagimin dhe tonin e lartë të zërit. Personi (viktima), ka qenë me trup të lartë dhe i zhvilluar fizikisht, dhe ka tentuar ta sulmoj F, të cilën e ka kapur për krahu dhe unë kam ndërhy që ta ndaj dhe ai është kthyer kah unë më ka kap për gjoksi dhe unë nga frika vetëm e ka shty me dy duart në gjoks dhe pas kësaj shtymje personi (viktima) ka ra në tokë me një guri të madh. Kam qenë shumë i frikësuar nga sulmi që do të më ndodhet, kur ka ra në tokë unë kam qenë i shqetësuar dhe nuk e di si kanë rrjedhur ngjarjet më vonë. Iniciator që të takohemi me viktimën ka qenë F, Vetura “Golf 2”, ka qenë e imja. F, më ka

thënë se tani i ndjeri është një shok i saj. Kur e kam parë të gjakosur viktimën pasi ka ra në guri, unë jam tronditur dhe kam humbur kontrollin. Pasi kam ardhë në vete e kam parë viktimën e cila nuk lëvizte, e pastaj së bashku me F, e A, e kemi mbuluar me dhe e jemi larguar nga ky vend. Pas vdekjes së personit kemi shkuar te vetura dhe me veturë kemi udhëtuar në drejtim të ..., ku i kemi hedhur gjësendet e viktimës në lum. Çantën në lum e ka hedhur A. Pastaj kemi shkuar në një restorant në ..., ku kemi qëndruar 10-15minuta. Rrugës kah jemi kthyer veturën e ka vozitur A. Në polici kam kuptuar se viktimja është nga ....

Prej dt.12.10.2014, deri me dt.17.10.2014, jemi takuar me F dhe A dhe F, i kam thënë se unë kam me tregu krejt. Unë i kam thënë F, pse më ke shti në këto sene. F, më ka thënë se unë shkoj dhe e marr rastin mbi vete. Mua më vjen shumë keq dhe jam shumë i tronditur për këtë rast që ka ndodhur pa pritmas.

I akuzuari A.M, në polici me dt.18.10.2014, në prezencën e avokates S. J, që është provë e pranueshme (sipas nenit 123 par.5 të KPPK), ka theksuar: me dt.12.10.2014, kam shkuar me nxjerr qymyr në .... Kemi ndej deri në ora 18:00. Pastaj në telefon më ka thirr E.K, më ka thënë eja në ... se kam punë shumë me ty. Ai ka ardhë me veturë "Golf 2", me të cilin kishte qenë edhe vajza me emrin F, sa më kujtohet ka qenë rreth orës 19:00. Të tre së bashku me veturën "Golf 2", kemi shkuar në .., te shtëpia e F. Ne e kemi pritur F, pak më lartë se shtëpia e saj, ajo ka shkuar i ka ndërruar teshat më pas, e ka thirr në telefon E, dhe i ka thënë hajde se dola te dyert. Më pas e kemi marrë F, me veturë dhe kemi shkuar në kafenenë "...", e cila gjendet në..., rreth orës 19:30. Më sa më kujtohet kemi hëngër bukë dhe kemi pi kafe. Kemi biseduar me E dhe F, në lidhje me një takim që kishte caktuar F, me një person, që sipas F, ku thojke se është gjerman, ndonjëherë thojke se është serb. F, ka pasur me u taku me atë personin që emrin nuk ia di. Edhe në këtë kohë F, ka shkuar në këmbë te ..., ndërsa E, me veturën "Golf 2", ka shkuar pas F, mua më kanë thënë me ndejt larg që kur të vijnë ata, është fjala për E, F, dhe personin tjetër që emrin nuk ia di. Këtë plan e kemi bërë fillimisht derisa kemi ndejt në kafenenë "...", në ..., kjo ide ka qenë e E, dhe F. Unë i kam pritur derisa kanë ardhur ata ia kam qitu dorën veturës të cilën e drejtonte E, me qëllim që të mendon personi i panjohur se E, është taksist. Unë kam hipur në veturë, në ulësen e mrapme, ndërsa personi që nuk ia di emrin ishte i ulur në ulësen e parë në veturë, ndërsa F, ishte ulur mrapa. E, ka vazhduar me veturë në drejtim të fshatit ..., kemi shkuar 300-400m, ka thirr dikush, me veturë E, është kthyer prapë në ..., kemi bërë një kthesë dhe jemi kthyer prapë kah kemi shkuar në afërsi të marketit "...", në .... Personi i panjohur ka biseduar në gjuhën angleze me F dhe ka thënë sipas F,, sa pare u kam borxh se nuk më pëlqen kjo vozitje me juve. Kemi vazhduar edhe 50m, e ka ndalë E veturën, personi ka dalë jashtë prej veturës dhe E e ka nxjerr letërnjoftimin dhe i është prezantuar si polic. Kemi dalë edhe ne jashtë, e kemi kapur për krahu dhe e kemi futur në veturë në ulësen e pasme. E i ka ra një shuplakë F, derisa kemi qenë jashtë veturës për ta frikësuar personin, nga ai moment E, ka kërkuar nga unë që ta vozis veturën, F është ulur përpara, ndërsa E, së bashku me atë personin është ulur mbrapa. E më ka thënë grahi për në fshatin ..., kemi shkuar deri te një vend që quhet "...", aty është fushë e rrethume-mal. Më ka thënë E, shyme veturën, pasi që kemi shkuar në atë lokacion e ka shym veturën dhe të katërtit kemi dal jashtë veturës. Personi është shtrirë në tokë dhe bisedojke me F dhe unë nuk i kam kuptuar se çka bisedonin sepse folshin anglisht. Derisa kemi qëndruar jashtë F, ka thënë me shku me ia marr në ..., një tabletë apo injeksion sepse duhet me qetësua se është shumë i shqetësuar. E tha se dikush duhet me ndejt me personin e panjohur, dikush me shku me ia marr ilaçet në .... Unë iu thash më mirë e lëshojmë personin ose e qojmë deri në ...dhe e lëshojmë se unë nuk guxoj me ndejt me ta. F dhe E, thoshin nuk bënë me e leshu se bien në "dell". Unë nuk e kam kuptuar se çka donë me thënë fjala "dell", mandej e kemi marrë personin e panjohur



dhe e kemi futur në veturë, e kemi vazhduar në drejtim të fshatit M., kur kemi shkuar atje E tha këtu duhet me ndalë kerrin se nuk kemi naftë. Kam shkuar në një pompë afër, e kam marrë një shishe me naftë. I kemi qitë veturës dhe jemi kthyer apat kemi vazhduar në drejtim të fshatit ..., jemi shkuar me veturë në fshatin ... dhe kemi vazhduar në drejtim të një mali mbi fshatin .., të Komunës së .. Derisa kemi mundur kemi me vazhdua me veturë, mandej kemi ecur në këmbë deri te një vend në mal te një bunar. Posa kemi arritur aty F, prapë ka biseduar me atë personin në gjuhën angleze, E i thojke F, thuaj këtij personi sa pare i jep me të lëshuar, ai thojke të jap sa të duash pare, por saktësisht sa pare i ka thonë nuk e di. E dhe F, kanë thënë këtë duhet me e mbyt se ky ka pare, nuk jep veç ikë. Mandej ia kemi lidhë duart me E dhe F, ia ka hjek rrypinë e pantallonave personit të panjohur, ia ka ngjit në fyt derisa personi ka qenë i shtrirë për tokë në krahun e majtë. E nga mbrapa, ia ka qitur këmbën në qafë dhe e ka shtrënguar me rrip në fyt derisa ka vdekur. Mandej F i mshojke me shkelm në bark, ndërsa E thojke kqyrne a është gjallë. E ka kapur një guri dhe i ka mshu mbrapa kokës dhe më ka detyru që edhe unë ti mëshoj me një guri prapa në kokë, ku edhe unë i kam mshu me guri njëherë mbrapa në kokë. Mandej ia kemi hequr teshat krejt, ia kemi marrë çantën, kuletën, telefonin dhe teshat, atë personin e kemi marrë dhe e kemi hudhë në një bunar aty afër, ia kemi qitë kapakun bunarit dhe ne kemi vazhduar me teshat e tija në drejtim të veturës. I kemi shti teshat në gepekun e veturë dhe kemi vazhduar në drejtim të .... Kur kemi ardhur në fshatin ..., në afërsi ku hudhet bërriloku i kemi djegur. Kuletën dhe çantën e kemi marrë nga F, më pas ma ka dhënë kuletën e shpraztë pa pare, pasi që paret i ka marrë F, unë i kam shti në çantën e krahut, e kemi shti edhe një guri në çantë dhe kemi shkuar te një lum në fshatin ..., dhe i kemi hudhë në lum, telefonin e atij personi ia kam dhënë E, dhe ai e ka gjuajtur në të njëjtin lum. Pasandej pas orës 24:00, kemi shkuar në muzikë në restorantin "...", në fshatin .... Kemi dëgjuar muzikë rreth gjysmë ore dhe kemi shkuar në një hotel në ... dhe kemi ndejtur gjysmë ore në dhoma të ndara. Unë vet, E me F, në një dhomë. Kemi dalë nga hoteli dhe F e kemi qar te shtëpia, ne kemi vazhduar te shtëpitë tona. Rreth orës 2:00 apo 3:00, kemi arritur në shtëpi. Në vendin e ngjarjes kemi shkuar unë dhe E dhe e kemi nxjerrë nga bunari dhe e kemi vendosur përfundi bunarit, e kemi mbuluar me dhe, ka qenë ditë e enjte. Mua mi ka dhënë 50Euro, E kur jemi dalë nga hoteli. Në atë moment nuk e di se çka kam bërë, por tash e kuptoj se çka kam bërë, më vjen shumë keq dhe pendohem shumë për këtë, por nuk ka qenë ide e imja, për me bë këtë veprim. I kërkoj falje sinqerisht familjes së viktimës dhe sot e kësaj dite nuk e di se kush ka qenë ai person. Unë kam menduar se ata kanë pasur për qëllim t'ia marrin do pare viktimës se F, dhe E, kanë thënë se viktima ka pare shumë dhe unë kështu kam menduar se me pas ditë se kanë për qëllim për ta mbytur unë kurrë nuk kisha shkuar me ta. Si ceka më lartë i kam lutur ta lëshojna atë person.

Në raportin e autopsisë për tani të ndjerin M.A, te përkrimi i dëmtimeve të jashtme është konstatuar:

1.Ne regjionin e djathtë muror të kokës, konstatojmë plagë shqyese ndrydhëse me përmasa 6,5x1,3cm, me formë vijezore të harkut të lehtë nga poshtë lartë, nga prapa para.

2. Nga cepi i sipërm i plagës së parë, nga pas konstatojmë plagën tjetër shqyese ndrydhëse e cila vazhdon nga pas me formë vizore të çrregullt, me përmasa 4,5x0,8cm.

3.Në fundin e plagës së parë, me distancë 0,3cm, konstatojmë plagë tjetër shqyese ndrydhëse (3) që shtrihet nga para- pas, në formë vijezore me përmasa rreth 5,5x1cm- nga kjo plagë tërheqim një copëz

guri të fortë, që mund të ketë qenë pjesë e mjetit më të madh goditës, shkaktar i dëmtimeve shqyese-ndrydhëse.

4.Paralel dhe pas me plagën e tretë në regjionin e pasmë të kokës, shtrihet plaga e katërt shqyese ndrydhëse në formë vizore ne përmasa 4,5x2cm.

5.Të gjitha këto plagë janë shkaktuar si rezultat i veprimit të mjetit të fortë mbrehtës.

6.Në regjionin e pasmë të majtë të kokës, konstatojmë plagë shqyese ndrydhëse me përmasa 0.2x0.2cm dhe formë të çrregullt.

7.Afër plagës së parë dhe pas konstatojmë plagën tjetër shqyese ndrydhëse me përmasa 4x0.2cm, në formë të shkronjës "Y", kurse bishti i shkronjës me përmasa 2x0.2cm.

8.Poshtë plagës dhe afër veshit të majtë konstatojmë plagën e tretë në pjesën e pasme të anës së majtë të kokës me përmasa 2x0.2cm.

9.Në regjionin e djathtë ballor të kokës konstatojmë ndrydhje dhe gërvishtje posmortale që paraqiten si rezultat i fërkimeve të indeve lëkurore në trup të huaj të fortë.

10.Në regjionin e mollëzës të anës së djathtë të fytyrës, konstatojmë gërvishtje posmortale me përmasa 1x0.5cm.

11.Në regjionin përreth syrit të majtë konstatojmë gjake mbledhje-coniuctivis traumatica.

12.Në regjionin e qafës, konstatojmë vijën stranguluese në anën e majtë të përparme të qafës, kurse në anën e përparme të majtë konstatojmë ndrydhje dhe skuqje që i përshtatet njëjës stranguluese të litarthit.

13.Në regjionin e djathtë të përparmë të krahut të djathtë konstatojmë ndrydhje posmortale.

14.Në regjionin e djathtë të poshtëm të gjoksit dhe regjionin e sipërm të barkut konstatojmë skuqje me diametër 6.8x7.5cm.

15.Në regjionin e shpinës konstatojmë për ngjyrimë të ndryshme, në regjionin e majtë të sipërm dhe regjionin e djathtë të poshtëm, për ngjyrim rozë e zbehtë, kurse mes për mes këtij dallimi të për ngjyrimit konstatojmë zbehje të lëkurës në formë të shiritit të gjerë që shkon nga ana e majtë-djathtas dhe pjerrtas dhe që shoqërohet me gërvishtje për ngjyrim kafeje të zbehtë.

16.Në shuplakët e duarve dhe shputat e këmbëve konstatojmë procese pseudomaceruese si rezultat i qëndrimit të gjatë në lagështi apo ujë.

17.Në regjionin e nyjave të duarve në shuplaka konstatojmë ndrydhje të indeve të buta, në formë të vijave që korrespondojnë me litarin e lidhur nëpër duar.

18.Në regjionin e gjurit të djathtë konstatojmë vrajë të vjetër, kurse në regjionin e përparmë të nën gjurit të majtë konstatojmë gërvishtje dhe ndrydhje me përmasa 7.7x1.6cm.

Te përshkrimi dëmtimeve të brendshme është konstatuar:

1.Në regjionin trunor, konstatojmë gjakderdhje masive trunore.

2.Në regjionin e djathtë të barkut, konstatojmë gjakderdhje mezenteriale.

3.Në regjionin e lobit të poshtëm të mushkërisë së djathtë konstatojmë pikëzime hemorragjike-njollat e Tadeit,

4.Në ventrikulin e djathtë konstatojmë koagule të shumta të gjakut.

Në fund të raportit të autopsisë është dhënë konkluzioni se vdekja ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes trunore nën dhe mbi cipat trunore si pasojë e veprimit mekanik të mjetit të fortë mbretës (si mund të jenë edhe copëza guri).

Eksperti mjeko ligjor Dr.N. U, në shqyrtimin gjyqësor të dt.28.08.2015, ka konstatuar se vdekja ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes trunore nën dhe mbi cipa trunore si pasojë e veprimit të mjetit të fortë mbretës.

Pas hapjes së kaviteve të organizimit gjatë procedurave standarde të autopsisë është bërë përshkrimi i dëmtimeve të brendshme ku janë konstatuar gjakderdhje masive trunore në regjionin trunor, në regjionin e djathtë të barkut janë konstatuar gjakderdhje mezenteriale të cipave mbështjellëse të zorrëve, kurse në regjionin e lobit të poshtëm të mushkërisë së djathtë janë konstatuar fiksime hemorragjike të njohura ndryshe si njolla të tardeit, të cilat paraqiten si rezultat i vuajtjes së organizimit për oksigjen. Në barkushen e djathtë të zerrës konstatohet koagule të shumta të gjakut.

I ndjeri dëmtime të brendshme në organizmin e tij ka pasur e të cilat janë:

Te dëmtimet e jashtme është përshkruar vija stranguluese në anën e përparme të qafës, si rezultat i së cilës janë paraqitur fiksime hemorragjike në globin e poshtëm të mushkërisë së djathtë si pasojë e vuajtjes së organizimit për oksigjen. Goditjet të cilat i janë bërë të ndjerit në kokë, në njërin plagë që është gjetur një pjesë e gurit, janë rezultat i goditjes nga mjeti mbretës i fortë i natyrës, plagët e konstatuara në regjionin e kokës janë shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë mbretës, të cilat janë vërtetuar me gjetjen e një copëze të gurit, e cila me besueshmëri të lartë i takon mjetit të fortë mbretës, i cili ka shkaktuar plagët në regjionin e kokës, forma e plagës shqyese ndrydhëse, në regjionin e kokës me diametrin e tyre me formën e çrregullt si dhe prezencën e një copëze të gurit, dëshmon se gjitha plagët e shkaktuara në regjionin e kokës janë shkaktuar si rezultat i veprimit të mjetit mekanik të fortë mbretës.

Njollat tardei, fiksime hemorragjike të gjetura në plogun e poshtëm të mushkërisë së djathtë të përshkruar si më lartë, kanë rezultuar me vuajtjen e organizimit për oksigjen dhe të cilat janë si pasojë e stangulimit të indeve të buta në regjionin e qafës, e të cilat kanë shkaktuar më së paku humbjen e vetëdijes së viktimës, kurse plagët tjera të përshkruara në raportin e autopsisë dhe të konstatuara në regjionin e kokës janë plagë të cilat kanë shkaktuar gjakderdhjen masive të indet e buta trunore që njëherit paraqesin plagë vdekjeprurëse.

Në këtë çështje penale nuk është kontestuese se tani i ndjeri M.A, ka vdekur si rezultat i gjakderdhjes trunore dhe mbi cipa trunore si pasojë e veprimit mekanik të mjetit të fortë mbretës.

E mitura F.C, ka pranuar kryerjen e veprës penale nga neni 179 par.1 nën par.1.4 dhe 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK, prandaj, me të miturën F, gjykata nuk do të merret deri te vendimi mbi dënim.

I akuzuari E.K, nuk mohon faktin se ditën kritike d.m.th. me dt.12.10.2014, së bashku me të miturën F.C dhe me të akuzuarin A.M, janë takuar në ..., sipas kërkesës së të miturës F.C, e pastaj me veturën e tij të markës “Golf 2”, e kanë marrë tani të ndjerin M.A, kanë shkuar në vendin e ngjarjes në një mal në fshatin ..., mali i ..., dhe aty sipas të akuzuarit, ka filluar një mos marrëveshje në mes të tani të ndjerit M.A dhe të miturës F.C. Meqenëse tani i ndjeri M.A, sipas mbrojtjes së të akuzuarit i është kanosur të miturës F.C, ky d.m.th. i akuzuari E ka shtyer të ndjerin M.A, i cili është rrëzuar dhe ka ra me kokë në një guri, e mandej nuk është ngritur. Pasi i ndjeri M.A, ka mbetur i vdekur të njëjtin e kanë shti në një gropë dhe e kanë mbuluar me dhe.

Nga deklarata e të akuzuarit A.M, vërtetohet se sipas kërkesës së të akuzuarit E.K, janë takuar me E.K dhe të miturën F.C, pastaj në restorantin “...”, në ..., kanë biseduar për t’ia marrë paratë tani të ndjerit M.A. Kanë bërë planin që pasi e mitura F.C, të takohet me tani të ndjerin M.A, i akuzuari E.K, të paraqitet me veturën e tij “Golf 2”, si taksist, ndërsa pasi këta tre të bëhen bashkë, më larg të paraqitet edhe i akuzuari A.M, si udhëtar i rastit, për ta bindur tani të ndjerin M.A, se i akuzuari E. K, është taksist, ndërsa i akuzuari A.M, është udhëtar i rastit. Sipas marrëveshjes ashtu edhe vepruan, kështu që pasi e mitura F.C, e takon tani të ndjerin M.A, te rrethi në ..., aty tani paraqitet si taksist E.K, i cili e merr të miturën F.C dhe të ndjerin M.A, ndërsa në rrugë e sipër e marrin edhe të akuzuarin A.M. Tani të akuzuarit E. K, A.M dhe e mitura F.C, të ndjerin M.A, e dërgojnë në fshatin ..., në mal të ..., në afërsi të një bunari. Tani të dy të akuzuarit dhe e mitura F.C, tani të ndjerit M.A, ia lidhin duart me lidhëse të këpucëve dhe me një maicë, ndërsa e mitura F.C, tani të ndjerit ia hjek rripin nga pantallonat dhe ia vendosin në qafë. I akuzuari E.K, për ta privuar nga jeta të ndjerin M, rrypinë që ia kishte lidhur rreth qafës e tërheq duke e shkelur të ndjerin mbrapa në shpinë për t’ia zënë frymëmarrjen e për ta privuar nga jeta. Në ndërkohë vërejnë se i ndjeri M.A, akoma është gjallë prandaj, i akuzuari E.K dhe i akuzuari A.M, marrin gurë dhe godasin në kokë tani të ndjerin M, duke i shkaktuar lëndime që më hollësisht janë përshkruar si në raportin e autopsisë, po ashtu edhe në konstatimin dhe mendimin e ekspertit Dr.N.U, në shqyrtimin gjyqësor kështu që nga bashkëveprimi i të akuzuarit E.K, A.M dhe të miturës F.C, i ndjeri M.A, vdes.

Mbrojtja e të akuzuarit dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit E. K, se i njëjti nuk ka privuar nga jeta tani të ndjerin M.A, është e pabazuar, në kundërshtim me deklaratën e tij të dhënë në polici, që u përshkrua më lartë, kur nuk ka mohuar se ka qenë në vendin e ngjarjes, se kinse e ka shty të ndjerin M.A dhe nga kjo shtyerje i ndjeri M.A, ka ra në një guri me kokë ku edhe ka mbetur i vdekur. Një mbrojtje e tillë e të akuzuarit, është në kundërshtim me provat e administruara sepse i akuzuari E.K, duke e ditur zhvillimin e ngjarjes në detale, duke e goditur të ndjerin M.A, me gur në kokë, nga të cilat lëndime i ndjeri M.A, ka vdekur, mbrojtjen e tij ka tentuar t’ia përshtat zhvillimit të ngjarjes se M.A, ka vdekur vetëm nga shtyrja e të akuzuarit E.K, duke ra në guri e duke marrë lëndime vdekjeprurëse. Pasi është gjetur trupi i pa jetë i M, në foto dokumentacion shihet se i njëjti i ka duart e lidhura me lidhëse të këpucëve dhe maicë, prandaj tani i ndjeri me duar të lidhura nuk ka mundur të sulmoj askënd e aq më pakë në rrethana kur dy të akuzuarit dhe e mitura e kishin dërguar të ndjerin në mal.

Gjithashtu edhe mbrojtja e të akuzuarit dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A.M, se i njëjti nuk e ka qëlluar me gur me vullnetin e tij të lirë tani të ndjerin M, është e pabazuar. I akuzuari A.M, nuk

mohon faktin se të ndjerin M.A, me guri e ka goditur në kokë, por mbrohet se për veprimin e tij nuk ka pasur vullnet, por të njëjtin sipas tij e ka detyruar E.K, që me gur ta godas në kokë tani të ndjerin M.A. Një mbrojtje dhe pretendim i tillë është i pabazuar, është i pa mbështetur në asnjë provë, i drejtuar në zvogëlimin e përgjegjësisë penale, sepse i akuzuari A.M, në bashkëkryerje me të akuzuarin E.K dhe të miturën F.C, vepruan sipas planit paraprak që tani të ndjerin M.A, ta privojnë nga jeta.

Pra, nga provat e theksuara më lartë vërtetohet fakti se të akuzuarit E.K dhe A.M, dhe e mitura F.C, në bashkëkryerje, me dashje privuan nga jeta tani të ndjerin M.A ashtu si është përshkruar më lartë si te gjendja faktike ashtu edhe te konstatimet tjera si të gjykatës së shkallës së parë, e po ashtu edhe të kësaj gjykate.

Të akuzuarit E.K dhe A.M, nuk njiheshin me të tani të ndjerin M.A. E mitura F.C, shtrej se e dashuronte tani të ndjerin M.A. Të akuzuarit E.K dhe A.M, nuk kishin ndonjë hasmëri apo raport të pa zgjidhur me tani të ndjerin M.A, që të ndjerin ta privojnë nga jeta. Motivi i vetëm që ta privojnë nga jeta të ndjerin M.A, ishte se e mitura F.C, i kishte njoftuar të akuzuarit se M.A, ka shumë para dhe nga interesi material të akuzuarit E.K dhe A.M, dhe e mitura F.C, privuan nga jeta tani të ndjerin M.A.

Iniciatore dhe organizatore e këtij rasti ishte e mitura F.C. E mitura F.C, shtrej se e dashuronte të ndjerin M.A. E mitura F.C, duke e shfrytëzuar ndjenjën e dashurisë që kishte tani i ndjeri M.A, ndaj të miturës F.C, F ditën kritike la takimin me tani të ndjerin M.A. F.C, për takimin që kishte lënë me M.A, i njoftoi të akuzuarit E.K dhe A.M. Tani të akuzuarit dhe e mitura F.C, në mënyrë dinake e marrin të ndjerin M.A, në atë mënyrë që F.C, kinse si person që e dashuron M.A, takohet me të njëjtin kinse për të shkuar për të shëtitur në ..., i akuzuari E.K, gjithashtu paraqitet në mënyrë dinake kinse është taksist në të egër, ndërsa i akuzuari A.M, gjithashtu në mënyrë dinake, paraqitet si udhëtar i rastit, ndërsa i akuzuari E, pastaj paraqitet edhe si polic, ndërsa që të tre ishin marrë vesh mes veti për t'ia përgatitur kurthin e pastaj për ta privuar nga jeta tani të ndjerit M.A, e në këto veprime të të akuzuarve dhe të miturës ekzistojnë elementet e dinakërisë së të akuzuarve dhe të miturës, duke e dërguar të ndjerin M, në vendin e ngjarjes ku edhe e privuan nga jeta.

Të akuzuarit E.K dhe A.M dhe e mitura F.C, privuan nga jeta tani të ndjerin M.A, duke ia lidhur duart të njëjtit me lidhëset e këpucëve, duke ia lidhur rripin e pantallonave në qaf, për ta ngulfatur tani të ndjerin, duke e goditur të dy të akuzuarit më gur në kokë tani të ndjerin M.A, e mitura F.C, duke e goditur të ndjerin me shqelma, me këto veprime të ndjerin M.A, e privuan nga jeta, duke i shkaktuar gjakderdhje në tru, si pasojë e të cilave M.A, edhe vdiq në vendin e ngjarjes. Pas kësaj të akuzuarit e zhveshin të ndjerin M, ia marrin kuletën me para në shumë prej 200 Euro dhe të ndjerin e gjuajnë në një bunar për ta fshehur kufomën. Menjëherë pas kësaj ngjarjes kritike të akuzuarit dhe e mitura shkojnë në një restorant në fshatin ..., ku dëgjojnë muzikë, pastaj kthehen në një restorant në Fushë Kosovë, ku i akuzuari E.K dhe e mitura F, kryejnë marrëdhënie seksuale.

Nga kjo që u tha më lartë, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve se gjendja faktike nuk është vërtetuar e plotë, ajo që është vërtetuar është e gabuar, janë pretendime të pabazuara.

Pretendimet për shkeljen e ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. K, në ankesë pretendon se është shkelur ligji penal sepse në bazë të gjitha provave i akuzuari E.K, nuk ka kryer veprën penale, sepse vepra penale për të cilën është akuzuar dhe është dënuar i akuzuari nuk është vepër penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av.Xh.M, pretendon se është shkelur ligji penal, nga neni 385 par.1 nën par.1.3 të KPRK. Duke iu referuar dispozitivit të aktgjykimit rrjedh se i mbrojturi im është shpallur fajtor për bashkëveprim, për motiv të dobisë pasurore në mënyrë dinake dhe mizore. Sipas nenit 179 par.1 nën par.1.4 dhe 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK, janë paraparë forma të rënda që e kualifikojnë një vrasje si vrasje të rëndë. Privimi i kundërligjshëm nga jeta i personit tjetër, por kur vrasje është përcjell me një rrethanë të posaçme kualifikuese e cila veprën e vrasjes e bënë më të rëndë, me rrezikshmëri më të madhe, duke e dalluar nga vrasja e rëndomtë. Duke analizuar aspektin teorik të disa veprave penale të vrasjes së rëndë, ligjdhënësi ka paraparë dy forma të vrasjes së rëndë: sipas mënyrës së kryerjes edhe atë mënyrën dinake dhe mizore.

I ndjeri-viktima nuk ka ndier këto dhimbje pasi në momentin e furjes me rrip kishte humbur vetëdijen. Ky përfundim mbështetet në konstatimin dhe mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr.N.U, kur ka konstatuar se (fiksime hemoragjike) të gjetura në lobin e poshtëm të mushkërisë së djathtë kanë rezultuar në vuajtjen e organizmit për oksigjen, e të cilat janë si pasojë e strngulimit të indeve të buta në regjionin e qafës, të shkaktuara nga humbja e vetëdijes së viktimës. Nuk ka vrasje mizore nëse në rastin kur kryhet ndaj personit i cili është në gjendje të pa vetëdijshme. Kjo vrasje nuk mund të cilësohet si vrasje dinake pasi nuk janë përmbushur kushtet dhe rrethanat të cilat do të vërtetonin elementin kualifikues të dinakërisë. Ana objektive shprehet në mënyrën e veprimit, fshehurazi, përdorimi i mjeteve të posaçme (helme etj.), ndërsa elementi subjektiv i referohet veprimit të kryesit në zgjedhjen e mënyrës së kryerjes së veprës, duke e sjellë viktimën në atë gjendje që të mos mund të mbrohet, duke e tërhequr viktimën në një prit, në gjendje të dehur apo të fjetur.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është i pa qëndrueshëm edhe pse mungon qëllimi i përfitimit të dobisë pasurore në anën e të akuzuarit A.M edhe pse s'janë plotësuar asnjë nga kushtet e parapara në nenin 179 par.1 nën par.6 i KPRK. Gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar ekzistimin e motivit në anën e A.M, prandaj edhe është shkaktuar shkelja e ligjit në dëm të akuzuarit. Vrasja e rëndë nga motivi i posaçëm i dobisë pasurore mund të kryhet vetëm me dashje direkte, e cila tek i mbrojturi im ka munguar dhe nuk është provuar me asnjë fakt konkret.

Pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve, janë pretendime të pabazuara.

E mitura F.C, ditën kritike në orët e mbrëmjes kishte lënë takimin me tani të ndjerin M.A. Për këtë takim ish-in njoftuar të akuzuarit E.K dhe A.M, që të tretë ish-in takuar në kafiterinë "...", ku e mitura F, kishte njoftuar të dy të akuzuarit se M, ka shumë pare dhe të njëjtin duhet t'ia marrin paratë, duke organizuar në atë mënyrë që kinse e mitura F, po takohet me tani të ndjerin M, për të shëtitur në .... Pasi e mitura F takohet me të ndjerin M, i akuzuari E, paraqitet me veturën e tij kinse si taksist në të egër, i cili i merr me veturë tani të ndjerin M dhe të miturën F, vazhdojnë rrugën, pak më larg kinse si udhëtar i rastit paraqitet A.M, të cilin e marrin në veturë, tani i ndjeri M.A, bënë vërejtje se nuk i pëlqen kjo mënyrë e vozitjes dhe

kërkon që i akuzuari E.K, ta ndalë veturën duke i pyetur se sa u ka borxh për shërbimin që i ka bërë i akuzuari E me veturë deri atëherë, i akuzuari E.K, paraqitet si polic, ndërsa të miturën e godet me shuplakë, kështu që të tretë e marrin viktimën M.A, e qojnë në vendin e ngjarjes ku edhe e privojnë nga jeta.

Paraqitja e të miturës F, si dashnore e vërtetë e të ndjerit M.A, lënja e takimit me te kinse për të shëtitur në ..., pastaj paraqitja e të akuzuarit E.K, si taksist i rastit, paraqitja e të akuzuarit A.M, si udhëtar i rastit, pastaj edhe paraqitja e të akuzuarit E.K si polic, paraqesin sjellje dinake të të akuzuarve dhe të miturës, sipas planit të përgatitur që më herët se si do të veprojnë, ndërsa iniciatorë dhe organizatorë e vrasjes së të ndjerit M.A, është e mitura F.C.

Si është thënë edhe më herët i ndjeri M.A, nuk njihet me të akuzuarit E.K dhe A.M, të miturën F.C, e dashuronte në mënyrë të sinqertë. Kishte planifikuar martesën me të njëjtën, duke porositur babain e tij, që t'ia sigurojë një restorant në ..., ku ka jetuar tani i ndjeri M, andaj të akuzuarve dhe të miturës F.C, tani i ndjeri M, nuk u kishte kurrfarë borxhi apo kurrfarë raporti të pa zgjidhur, prandaj, si e mitura po ashtu edhe të akuzuarit nuk kishin kurrfarë motivi tjetër që ta marrin tani të ndjerin ta dërgojnë te vendi i ngjarjes dhe ta privojnë nga jeta, por i vetmi motiv ishte me qëllim të fitimit të dobisë pasurore edhe ate që të ndjerit t'ia marrin paratë meqenëse e mitura F.C, konsideronte se i ndjeri M, ka shumë para, këtë edhe u kishte thënë të akuzuarve E e A, prandaj, vërtetohet fakti vendimtar se i vetmi motiv i të akuzuarve dhe të miturës, për ta privuar nga jeta të ndjerin, ishte fitimi i dobisë pasurore.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit të mjekësisë ligjore, vërtetohet se vdekja e tani të ndjerit M.A, ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes nën trunore dhe mbi cipat trunore si pasojë e veprimit mekanik të mjetit të fortë mbretë, ndërsa te dëmtimet e jashtme është përshkruar vija stranguluese në anën e përparme të qafës si rezultat i të cilës janë paraqitur fiksime hemoragjike në globin e poshtëm të mushkërisë së djathtë si pasojë e vuajtjes së organizmit pa oksigjen e të cilat janë si pasojë e strangulimeve të indeve të buta në regjionin e qafës e të cilat kanë shkaktuar humbjen e vetëdijes së viktimës. Nga foto dokumentacioni i përpiluar gjatë autopsisë së tani të ndjerit vërtetohet se tani i ndjeri nga të akuzuarit është goditur tetë herë me gur në kokë, por meqenëse të ndjerit së pari i është vu rripi-laku në qafë, e pastaj është goditur me gur në kokë, ndërsa sipas ekspertit mjeko-ligjor, rripi-laku në qafë ka shkaktuar humbjen e vetëdijes, gjykata në mënyrë të sigurt nuk ka vërtetuar rrethanën objektive të mizorisë ndaj tani të ndjerit që d.m.th. se gjykata nuk ka vërtetuar faktin se tani i ndjeri M.A, ka pasur vuajtje të mëdha apo vuajtje që tejkalojnë vuajtjet te vdekja me dhunë, gjatë privimit të tij nga jeta për shkak të vënies së lakut në qafë edhe pse në anën e të akuzuarve dhe të miturës, ekzistojnë disa elemente subjektive të vrasjes mizore, sepse pasi të akuzuarit dhe e mitura e privojnë nga jeta tani të ndjerin M, shkojnë në restorantin "...", në ..., ku dëgjojnë muzikë, pastaj kthehen në një restorant tjetër në ..., ku e mitura F dhe i akuzuari E bëjnë seks, por me gjithë ekzistimin e elementeve subjektive të vrasjes mizore nuk plotësohen elementet objektive, prandaj në rast të dyshimit sipas nenit 3 par.2 të KPPK, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të akuzuarve, prandaj edhe gjykata gjen se në rastin konkret nuk është provuar fakti se të akuzuarit dhe e mitura në mënyrë mizore kanë privuar nga jeta të ndjerin M.A.

Në nenin 179 par.1 nën par.1.4 të KPRK, është paraparë vrasja në mënyrë mizore apo dinake, kështu që në rastin konkret edhe pse kjo gjykatë gjen se kemi të bëjmë me vrasje dinake, por ka mëdyshje

për vrasjen mizore, që është interpretuar në favor të akuzuarve, meqenëse të dy format janë paraparë në par.1 nën par.1.4 të nenit 179 të KPRK, sa i përket kualifikimit juridik mbetet i njëjtë.

Nga të gjitha provat e administruara vërtetohen faktet se të akuzuarit E.K e A.M dhe e mitura F.C, bënë planin për vrasjen e të ndjerin M.A, realizuan të njëjtin duke e privuar nga jeta, prandaj, te të dy të akuzuarit E.K e A.M, si dhe te e mitura F.C, ka ekzistuar dashja direkte dhe ate paramendimi si formë më e rëndë e dashjes, të akuzuarit dhe e mitura, kanë vepruar me vetëdije dhe vullnet, prandaj të njëjtit veprën e kryer me dashje direkte me paramendim.

Nga arsyet që u thanë më lartë kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejt ka zbatuar ligjin penal, kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit E.K dhe A.M dhe të miturës F.C, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.4 dhe 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK, për të cilën vepër penale dhe i ka shpallur fajtor pasi më parë ka gjetur se të akuzuarit dhe e mitura janë penalisht përgjegjës.

Pretendimet për shkak të vendimit mbi dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.K, pretendon se të akuzuarit i është caktuar sanksioni penal më i rëndë i mundshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i pa qëndrueshëm edhe për shkak të vendimit për dënim. Kjo para se gjithash ngase në arsyetim të aktgjykimit lidhur me përcaktimin e llojit të dënimit dhe me rastin e caktimit të burgimit të përjetshëm është e domosdoshme që gjykata të vërtetoj dhe konkretizoj arsyet dhe rrethanat veçanërisht rënduese që janë shkaktuar pasoja shumë të rënda. Në aktgjykim nuk janë konkretizuar apo arsyetuar asnjë rrethanë veçanërisht rënduese, si parakusht për mundësinë e dënimeve me burgim të përjetshëm. Nuk është kontestuese se si pasojë e veprës penale të vrasjes është vrarë një person, i ndjeri M.A, po ashtu është vërtetuar se me rastin e djegies së rrobave të ndjerit, i akuzuari E nga xhepat e pantallonave ia merr 200 Euro, por kjo nuk është element i mjaftueshëm për cilësimin e vrasjes së rëndë, ndaj të mbrojturit tim i cili kishte marrë 50 Euro, nga i akuzuari E, në emër të kthimit të borxhit të mëhershëm. Po qesë analizohet arsyetimi i dhënë në aktgjykim sa i përket vendimit mbi dënim në mënyrë të pa mohueshme konfirmohet fakti se gjykata në këtë rast rrethanat rënduese të cekura nuk i trajton si rrethana veçanërisht rënduese, ngase nuk ka gjetur asnjë prove konkrete për të cilësuar si rrethana të tilla. Meqë është kështu atëherë nuk ka pasur bazë ligjore për cilësimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Nga ana e të mbrojturit tim ka një varg rrethanash lehtësuese të cilat gjykata nuk i ka marrë parasysh dhe nuk i ka vlerësuar fare.

Mbrojtësi i të miturës F.C, av.Rr.G, pretendon se me vet faktin se e mitura që nga zbulimi i kryerjes së veprës, në asnjë moment nuk ka mohuar veprimet e saj, gjë e cila u finalizua me pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, nga kjo rezulton se nuk është fare kontestuese përgjegjësia e saj penale me veprën penale me të cilën ngarkohet. Sa i përket vendimit mbi dënim, gjykata është dashur ti kushtoj kujdes të veçantë analizimit dhe vlerësimit të gjitha rrethanave rënduese dhe atyre lehtësuese. Gjykata nuk i ka kushtuar rëndësi rrethanave lehtësuese. E mbrojtura ime ka pranuar fajësinë dhe me këtë ka lehtësuar punën e gjykatës që të vije deri te e vërteta. Me këtë është dashur të përfitoj bëni fitet nga pranimi i fajësisë. E mbrojtura ime nuk e ka ngulfatur me rrip të ndjerin M dhe nuk e ka goditur me gur. E mitura F, deklaroi se e ka goditur të ndjerin vetëm me këmbë. Gjatë shqyrtimit të ankesës gjykata duhet të ketë



parasysh se e mbrojtura ime është e moshës së re, e gjendjes së dobët ekonomike, e pa punë, ndaj saj nuk zhvillohet procedurë tjetër, është vajzë e prindërve të divorcuar, ka kërkuar falje familjes së të dëmtuarit dhe se do ta brenë ndërgjegjja tërë jetën.

Pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarit E.K dhe A.M, se dënimi i shqiptuar është i ashpër, janë të bazuara, ndërsa pretendimi i mbrojtësit së të miturës F.C, se dënimi i shqiptuar është i ashpër është i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimeve thotë se ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të paraparë në nenin 73 dhe 74 të KPRK, ku për të akuzuarin E.K dhe A.M, nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese, ndërsa për të miturën F.C, ka marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarit dhe të miturën, ka marrë shkallën e lartë të pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale, shkallën e lartë të dashjes, përdorimin e dhunës dhe të kanosjes, në kryerjen e veprës penale, kryerjen e veprës penale në mënyrë posaçërisht mizore, se viktimja ka qenë posaçërisht e pa mbrojtur, mosha e re e viktimës-viktima ishte 24 vjeçar, se viktimja me asnjë veprim nuk ka provokuar e as nuk ka kontribuar veprës penale, shkallën e lartë të dëmit të shkaktuar, se i akuzuari E, ka qenë edhe më parë i dënuar për një vepër tjetër penale dhe të njëjtëve iu kanë shqiptuar dënimet e cekura më lartë.

Kjo gjykatë i aprovon rrethanat lehtësuese që i ka pasur gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit të miturës F.C, se e mitura ka pranuar fajësinë, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer, ndërsa si rrethana rënduese moshën e viktimës i cili ishte 24 vjeçar, si dhe faktin se me asnjë veprim tani i ndjeri M, nuk ka kontribuar që të pësoj atë që ka pësuar, ndërsa rrethanat tjera rënduese kjo gjykatë nuk mund ti aprovoj ato që i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, si janë rrethanat rënduese se të akuzuarit dhe e mitura kanë marrë pjesë në shkallë të lartë në kryerjen e veprës penale, sepse të akuzuarit janë shpallë fajtor për bashkëkryerje, që është shkalla më e lartë e bashkëveprimit, gjithashtu nuk mund të aprovoj edhe rrethanën tjetër përdorimin e kanosjes dhe dhunës, sepse këtu kemi të bëjmë me dhunën e përdorur për ta privuar nga jeta të ndjerin, prandaj e njëjta nuk mund të merret si rrethanë rënduese, ndërsa sa i përket vrasjes mizore kjo gjykatë ka dhënë gjetjet e saja, prandaj vrasja mizore nuk mund të merret si rrethanë rënduese.

Kjo gjykatë nuk mund të aprovoj konstatimin e gjykatës së shkallës së parë, se në anën e të akuzuarve E e A, nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese.

Është fakt se e mitura F.C, ka pranuar kryerjen e veprës penale apo thënë në terminologjinë e madhorëve, ka pranuar fajësinë, se ka shpreh keqardhje për veprën e kryer, por këto rrethana lehtësuese janë minore në raport me rrethanat tjerë rënduese se e mitura është iniciatore dhe organizatore e privimit nga jeta të tani të ndjerit M.A, se pikërisht e mitura F.C, duke u paraqitur se e dashuron të ndjerin M.A, me të njëjtin la takim, duke u organizuar me të akuzuarit E.K e A.M, e futi në kurth tani të ndjerin M.A, duke e dërguar në vendin e ngjarjes, ku edhe është privuar nga jeta në mënyrën si është përshkruar te gjendja faktike, pastaj duke e gjuajtur në bunar trupin e pa jetë të tani të ndjerit M.A, pas ekzekutimit duke shkuar për të dëgjuar muzikë, e pastaj për të shkuar për të bërë seks me të akuzuarin E. K, e në ditët në vijim derisa është arrestuar nga policia duke luajtur rolin e shenjtores, të gjitha këto rrethana e mitura F.C, i ka kryer me dashje, prandaj, edhe të miturën F.C, e bëjnë që të ketë rol kryesor në privimin nga jeta të tani të

ndjerit M.A, prandaj, dënimi i shqiptuar të miturës F.C, është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, për të cilën është shpallur përgjegjëse e mitura F.C, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të miturës dhe sipas bindjes së kësaj gjykate vetëm me dënimin e shqiptuar ndaj të miturës do të arrihet qëllimi i burgimit për të mitur i paraparë në nenin 32 të KDM, e që është që të kontribuohet në rehabilitimin e të miturës F.C, në zhvillimin e të miturës veçanërisht në edukimin e të miturës, në edukimin e specializuar, në aftësinë profesionale të saj dhe në zhvillimin e duhur personal, e përveç kësaj dënimi me burgim për të mitur duhet të ndikoj pozitivisht në të miturën përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin e të miturës.

Dënimi me burgim të përjetshëm, për të akuzuarit E.K dhe A.M, sipas kësaj gjykate është i ashpër. Gjykata e shkallës së parë, thotë se në anën e të akuzuarve nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese, këtë konstatim nuk mund ta aprovoj kjo gjykatë, sepse të akuzuarit E.K e A.M, janë të moshës relativisht të re, më parë të pa gjykuar (edhe pse gjykata e shkallës së parë thotë se E.K, ka qenë më parë i gjykuar, pa u thirrur në vendim konkret, vepër konkrete dhe dënim konkret), të gjendjes së dobët ekonomike, kanë të kryer vetëm shkollën fillore që tregon nivelin e tyre të të kuptuarit të vlerave të shoqërisë, i akuzuari A.M, duke u penduar për veprën e kryer, duke pasur parasysh se kjo gjykatë nuk ka mundur ti aprovoj rrethanat rënduese të cilat janë numëruar më lartë, duke pasur parasysh se as gjykata e shkallës së parë e as kjo gjykatë, nuk kanë vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në rrethana veçanërisht rënduese apo se vepra penale ka shkaktuar pasoja shumë të rënda, pa llogaritur elementet kualifikuese të veprës penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, sepse elementet kualifikuese të veprës penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor nuk mund t'u merren si rrethana rënduese, por duke i pasur parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si dhe rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit dhe atë se të akuzuarit kanë vepruar me paramendim që është shkallë e lartë e dashjes, moshën e viktimës si të re, sjelljen të akuzuarve pas kryerjes së veprës penale duke e gjuajtur në bunarë të akuzuarin, duke ia djegur të gjitha rrobat, duke shkuar në muzikë pas krimit, pastaj duke shkuar edhe në hotel, ku i akuzuari E K, qonë dashuri me të miturën F, kjo gjykatë megjithatë gjen se dënimi i shqiptuar të akuzuarve me burgim të përjetshëm është i rëndë, sepse është dënim më i rëndë i paraparë me KPRK, dhe me vënien në fuqi të njëjtit, të akuzuarve nuk u epet kurrfarë shanse për përmirësim dhe gjykata do të nisej nga qëndrimi se të akuzuarit e kanë vendin gjatë gjithë jetës në burg, duke pasur parasysh se të akuzuarit janë të moshës relativisht të re, bindja e gjykatës është se të akuzuarit me dënime me burgim në kohë të caktuar do të risocializohen, ndërsa me burgim të përjetshëm do të thotë që këta dy të akuzuar nuk do të risocializohen, e në këtë konkludim kjo gjykatë nuk ka rrethana të prekshme që do të shpien në këtë konkludim, prandaj, kjo gjykatë gjen se dënimi me burgim të përjetshëm ndaj të akuzuarve është i ashpër, prandaj edhe kjo gjykatë ndryshoi vendimin mbi dënim, duke i shqiptuar dënimet si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë të akuzuarin E.K, duke e gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 25(njëzetepesë)vite, sepse roli i të akuzuarit E.K, pas të miturës F.C, është më i madh, se i njëjti nuk ka treguar as shenjë më të vogël të pendimit dhe keqardhjes, ndërsa të akuzuarin A.M, e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 22(njëzetedy)vitesh, sepse roli i të akuzuarit A.M, është më i vogël në raport me të akuzuarin E. K, se i njëjti ka pranuar shumë veprime inkriminuese se i njëjti është penduar për veprën e kryer, prandaj, kjo gjykatë gjen se dënimet e shqiptuara të akuzuarve E.K dhe A.M, janë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, si dhe rrethanat në të cilat kanë kryer veprën penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve E.K dhe A.M, e gjithashtu me bindje se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve, në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit,

i paraparë në nenin 41 të KPRK, e që është të parandaloj të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e të akuzuarve, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale dhe të ndikoj në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 401 dhe 403 par. 1 nën par.1.2 të KPPK.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.94/2016, me datë 02.03.2016

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

1.Vahid Halili

\_\_\_\_\_

2.Abdullah Ahmeti

\_\_\_\_\_

Kryetari i Kolegjit,

Fillim Skoro

\_\_\_\_\_